



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 175

Tiranë – E mërkurë, 4 tetor 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe
Urdhër i Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar nr. 2178, datë 3.10.2017	Për delegim të përkohshëm të kompetencave..... 8863
Udhëzim i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 365, datë 21.9.2017	Mbi zbatimin e vendimit nr. 31, datë 20.1.2001, të Këshillit të Ministrave, “Për përfitimet nga statusi i invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar..... 8863
Udhëzim i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 366, datë 21.9.2017	Mbi zbatimin e vendimit nr. 618, datë 7.9.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuara”, të ndryshuar..... 8864
Udhëzim i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 367, datë 21.9.2017	Mbi zbatimin e vendimit nr. 277, datë 18.6.1997, të Këshillit të Ministrave, “Për përfitimet nga statusi i të verbrit”, të ndryshuar..... 8864
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur dhe të vdekur të shtetasit Nexhip Muhamed Stari..... 8864

**URDHËR****Nr. 2178, datë 3.10.2017****PËR DELEGIM TË PËRKOSSHËM TË
KOMPETENCAVE**

Në zbatim të nenit 28 dhe nenit 29, të Kodit të Procedurave Administrative, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 58, datë 29.1.2014, “Për organizimin e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar”, neni 26 i rregullores së brendshme të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, miratuar me urdhrin e Kryeministrit nr. 1, datë 14.1.2015, “Për miratimin e rregullores së brendshme të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK)”, të ndryshuar me urdhrin nr. 150, datë 26.9.2017,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit në funksion të kontrollit të figurës së subjekteve të rivlerësimit, përgjegjësit të grupit të punës, z. Adhurim Hasanaj.

2. Z. Adhurim Hasanaj i delegohen kompetencat, si më poshtë:

a) Mbikëqyr dhe udhëzon grupin e punës për kontrollin e figurës së subjekteve të rivlerësimit gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij.

b) Përfaqëson grupin e punës në marrëdhëniet me:

- Komisionin e Pavarur të Kualifikimit;
- Kolegjin e Apelimit dhe Komisionerët Publikë;
- Operacionin Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM).

c) Organizon dhe drejton veprimtarinë e grupit të punës.

ç) Kryen çdo veprim tjetër të nevojshëm për realizimin e qëllimit, objektit dhe detyrave për të cilat është ngritur grupi i punës.

3. Ky urdhër do të jetë në fuqi për periudhën 5.10.2017 deri në 9.10.2017 dhe 16.10.2017 deri 20.10.2017.

4. Z. Hasanaj nuk mund t'i nëndelegojë këto kompetenca.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet z. Hasanaj, përgjegjës i grupit të punës, Drejtoria e Vetting-ut dhe Sigurimit Industrial, Drejtoria e Sigurimit, Administrimit të Dokumenteve dhe Regjistrimit Qendror, Sektori i Sigurimit të Sistemeve të Komunikimit dhe Informacionit,

Drejtorja e Financës, Shërbimeve Mbështetëse dhe Mbikëqyrjes Shtetërore.

6. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR
Dorian Tola

UDHËZIM**Nr. 365, datë 21.9.2017****MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 31,
DATË 20.1.2001, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRFITIMET NGA
STATUSI I INVALIDIT, PARAPLEGJIK
DHE TETRAPLEGJIK”, TË
NDRYSHUAR**

Mbështetur në pikën 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Shqipërisë, në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, të pikës 8, të vendimit nr. 31, datë 20.1.2001, të Këshillit të Ministrave, “Për përfitimet nga statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Masa e përfitimit për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të përcaktuar në pikën 4, të vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 31, datë 20.1.2001, bëhet 10.330 (dhjetë mijë e treqind e tridhjetë) lekë në muaj.

2. Masa e përfitimit për kujdestarin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, të përcaktuar në pikën 4, të vendimit nr. 31, datë 20.1.2001, të Këshillit të Ministrave, bëhet 10.850 (dhjetë mijë e tetëqind e pesëdhjetë) lekë në muaj.

3. Efektet financiare për zbatimin e këtij udhëzimi fillojnë nga 1 shtator i vitit 2017 dhe përballohen me fondet e akorduara për vitin 2017, për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

4. Udhëzimi nr. 19, datë 30.8.2016 i ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga 1.9.2017.

MINISTRI I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

**UDHËZIM**

Nr. 366, datë 21.9.2017

**MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 618,
DATË 7.9.2006, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E
KRITEREVE TË DOKUMENTACIONIT
DHE MASËS SË PËRFITIMIT TË
PAGESËS PËR PERSONAT ME AFTËSI
TË KUFIZUARA”, TË NDRYSHUAR**

Mbështetur në pikën 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, të pikës 27 të vendimit nr. 618, datë 7.9.2006, “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuara”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 8, të vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 618, datë 7.9.2006, bëhet 10.330 (dhjetë mijë e treqind e tridhjetë) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 1 të vendimit. Të njëjtën masë përfiton edhe kujdestari i personit me aftësi të kufizuara.

2. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 8, të vendimit nr. 618, datë 7.9.2006, të Këshillit të Ministrave, bëhet 10.330 (dhjetë mijë e treqind e tridhjetë) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 2, të vendimit dhe 10.850 (dhjetë mijë e tetëqind e pesëdhjetë) lekë në muaj për kujdestarin.

3. Efektet financiare, për zbatimin e këtij udhëzimi, fillojnë nga 1 shtatori i vitit 2017 dhe përballohen me fondet akorduara për vitin 2017, për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

4. Udhëzimi nr. 17, datë 30.8.2016, i ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga 1.9.2017.

**MINISTRI I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu**

UDHËZIM

Nr. 367, datë 21.9.2017

**MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 277,
DATË 18.6.1997, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRFITIMET NGA
STATUSI I TË VERBRIT”, TË
NDRYSHUAR**

Mbështetur në pikën 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, të pikës 16 të vendimit nr. 277, datë 18.6.1997, të Këshillit të Ministrave, “Për përfitimet nga statusi i të verbrit”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Masa e përfitimit për shkak të verbërisë, e përcaktuar në pikën 4, të vendimit nr. 277, datë 18.6.1997, të Këshillit të Ministrave, bëhet 11.730 (njëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e tridhjetë) lekë në muaj. Të njëjtën masë përfiton edhe kujdestari i të verbrit.

2. Efektet financiare, për zbatimin e këtij udhëzimi, fillojnë nga 1 shtatori i vitit 2017 dhe përballohen me fondet e akorduara për vitin 2017, për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

3. Udhëzimi nr. 18, datë 30.8.2016, i ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga 1.9.2017.

**MINISTRI I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu**

KËRKESË

Shtetasja Shpesa Stari, e bija e Mersinit dhe e Zojës, e datëlindjes 28.4.1945, lindur dhe banuese në Durrës, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, shpalljen të zhdukur dhe të vdekur të shtetasit Nexhip Muhamed Stari, i datëlindjes 19.2.1967, lindur dhe banues në Durrës.

**KËRKUES
Shpesa Stari**

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa: Rr “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel/fax +355 4 24 27 004 Tel +355 4 24 27 006

Çmimi 56 lekë